



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA SELENICE
DREJTORIA E INTEGRIMIT EUROPIAN DHE PROJEKTIMIT

Selenicë, më ____ / ____ / 2025

MIRATOHET

Titullari i Autoritetit Kontraktor

Nertil BELLAJ



DETYRË PROJEKTIMI

Për objektin:

“ NDËRTIM URE, FSHATI BRATAJ ”

Në përputhje me legjislacionin Shqiptar, Bashkia Selenicë kërkon të realizojë: Studimin dhe hartimin e projektit të zbatimit për objektin “ **NDËRTIM URE, FSHATI BRATAJ** ”

2025

I. Hyrje dhe Qëllimi

• Qëllimi i projektit

Projektimi i një ure automobilistike me gjatësi rreth **70-90 metra**, me **2 hapësira drite**, mbi lumin **Shushicë**, në njësinë administrative Brataj, **Bashkia Selenicë**, për të realizuar lidhjen infrastrukturore të fshatit Brataj me zonën përtej lumit.

Institucioni përfitues i shërbimit në fushën e projektimit është Bashkia Selenicë. Përfituesi i këtij shërbimi është Institucion Publik.

Misioni i këtij institucioni është të sigurojë një infrastrukturë sa më cilësore për popullatën, banorët duke rritur zhvillimin ekonomik të zonës si dhe rritjen e cilësisë së jetesës.

Përfituesi i projektit është komuniteti I Njesisë Administrative Brataj, fshati Brataj

Qëllimi është ndërtimi i një ure të qëndrueshme dhe funksionale për qarkullimin e automjeteve dhe këmbësorëve, që siguron:

- **Lidhje të sigurt** dhe të pandërprerë midis komuniteteve përreth.
- **Rritjen e aksesit** në tregje, shërbime dhe zhvillim ekonomik lokal.
- **Zëvendësimin** e kalimeve të përkohshme ose të pasigurta ekzistuese

Ky projekt është nevojë e rëndësishme e momentit e institucionit për realizimin e veprimtarisë së tij institucionale, si dhe përputhet me strategjinë e zhvillimit të Bashkisë Selenicë dhe orientimeve të ministrisë së linjës.

• Baza ligjore.

Bazuar në statusin ligjor të institucionit, ky shërbim në fushën e projektimit duhet të përmbushë kërkesat dhe të marrë në konsideratë referencat si vijon:

- Ligj Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”
- Ligj Nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i përditësuar
- Rregulloren e Zhvillimit të Territorit (në fuqi).
- VKM Nr.1503, datë 19.11.2008 “Për miratimin e Rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuar””.
- • Eurokode (EN 1990 – EN 1999)
- • Rregulloret shqiptare për ndërtim
- • Udhëzimet për projektim të strukturave të urave
- • Normat e sigurisë rrugore dhe qarkullimit.

• Përshkrim i detyrës së projektimit

Detyra e Projektimit ka për qëllim parashtrimin e të dhënave thelbësore, njohëse, kërkesave dhe nevojave specifike të institucionit përfitues, në cilësinë e Porositësit, kundrejt shërbimit

të kërkuar, si dhe orientimet mbi problematikën aktuale të shtruar për zgjidhje, mbi bazën e të cilave, grupi i projektimit, do të hartojë projektin për objektin :

“NDËRTIM URE NE FSHATIN BRATAJ ME HD = 35 m, L~ 70 m MBI LUMIN SHUSHICË

FAZA I - Projekt-ideja përfundimtare

Paraqitja e variantit të ndërhyrjes në bazë të rezultatit të vlerësimit ekonomiko-financiar, skemës së qarkullimit, bazuar në studimet e miratuara në organet kompetente. Të paraqitet varianti i propozuar me preventivin paraprak dhe volumet e shpronësimeve nëse ka duke pasur parasysh që të përcaktohet vendodhja më optimale duke analizuar kombinimin më ekonomik i cili del nga ndërthurja e elementëve (gjatësi ure – largësi nga fshati Brataj – relief dhe kosto ekonomike). Pas realizimit të projekt-idesë, projektuesi duhet të marrë miratimin nga Drejtoria e Planifikimit të Territorit Mjedisit dhe Investimeve për variantin e projektit të zbatimit. Në çdo rast, projekt-ideja përfundimtare dhe miratimi i saj duhet të jepen jo më vonë se gjysma e afatit të kontratës.

FAZA II - Projekt-zbatimi

Të kryhet hartimi i Projektit **“NDËRTIM URE, NË FSHATIN BRATAJ ME HD = 35 m, L~70 m MBI LUMIN SHUSHICË** i cili duhet të përmbajë:

- Llogaritjet.
- Raporti teknik.
- Preventivi i kryerjes së punimeve, duke u mbështetur në çmimet e miratuara në “Manualin Teknik të Çmimeve” të miratuar V.K.M. Nr.216 datë 13.04.2023, çmime të ofertuara më parë ose mbi çmime të shoqëruar me analiza përkatëse.
- Specifikimet teknike të zbatimit të projektit.
- Grafiku i punimeve.
- Paraqitja grafike e projektit.
- Preventivi përfundimtar dhe të paktën 70% e materialit grafik duhet të paraqiten pranë Drejtorisë së Studimeve, Planifikimit dhe Koordinimit të Investimeve.

Llogaritjet, specifikimet teknike, raporti teknik, grafiku i punimeve dhe preventivi Projekt zbatimi do të shoqërohet me llogaritjet përkatëse duke u bazuar në standardet shqiptare apo ndërkombëtare. Pjesë e projekt-zbatimit do të jenë raporti teknik, grafiku i punimeve, specifikimet teknike dhe preventivi me çmimet e miratuara në “Manualin Teknik të Çmimeve” të miratuar V.K.M. Nr.216 datë 13.04.2023, çmime të ofertuara më parë ose mbi çmime të shoqëruar me analiza përkatëse.. Paraqitja grafike e projektit Projekt-zbatimi duhet të përmbajë minimumi fletët si më poshtë:

- a) Topografinë e gjendjes ekzistuese për zonën që zbatohet projekti në të cilën janë të azhornuara të gjitha ndërtimet në gjendjen e sotme (me leje dhe pa leje) me Koordinata dhe përmasat përkatëse
- b) Planimetria shpronësimeve nqs ka SH 1:1000
- c) Planimetria e përgjithshme dhe relievi i zonës në SH 1:1000
- d) Planimetritë e përmasuara të sheshit në SH 1:500, 1:200
- e) Planimetritë teknike SHK. 1:100, V 1:200
- f) Profilet tërthore dhe gjatësore, si dhe vende me karakteristika të veçanta SH 1:100
- g) Detaje konstruktive tip të urës SH 1:20, 1:50.
- h) Planimetri për lidhjen me rrugët dhe detaje përkatëse SH 1:200

i) Grafiku i punimeve

Projekti do të hartohet në përputhje me të gjitha normat dhe standardet për projektim që parashikon legjislacioni në fuqi. Projektimi duhet të sigurojë respektimin e standardeve, madje edhe atyre gjatë zbatimit. Është përgjegjësi e projektuesit saktësia dhe respektimi i të gjitha standardeve dhe normave. Projektuesi mund të rekomandojë edhe prezantimin e standardeve të reja për përcaktimin me normat e BE-së, si dhe të praktikave më të mira ndërkombëtare në projektim dhe zbatim. Rekomandimet duhet të përmbajnë elemente të fizibilitetit dhe realizueshmërisë me praktiken shqiptare dhe imitimet për financimin e veprës. Në hartimin e projektit të mbahen parasysh të gjitha normat e miratuara për personat me aftësi të kufizuar, të verbrit, etj. Në projekt duhet të parashikohet infrastruktura e nevojshme për këto kategori. Detajet për këtë kategori të jepen në fletë të veçanta.

Standarde në paraqitjen e dokumentacionit teknik Rekomandime për projektuesin:

- Projektuesi duhet të përdorë dhe të rishikojë të gjithë informacionin ekzistues lidhur me urën që do të ndërtohet.
- Projektuesi duhet të përdorë studimet dhe të dhënat paraprake që disponohen nga Bashkia Selenicë, Drejtoria e Planifikimit të Territorit, Mjedisit dhe Investimeve dhe nga ASHK-ja.
- Në hartimin e projektit duhet të merren parasysh dhe standarde të tjera të nxjerra nga Bashkia Selenicë.
- Cilësia e studimit duhet të jetë e tillë që të arrihet standarti i kërkuar.

II. Të dhënat bazë të projektit

• Topografia dhe planimetria

Fshati Brataj shtrihet në luginën mes maleve të Shushicës, qendra e fshatit është rreth $\approx 250-260$ m mbi nivelin e detit. Në shtratin aktiv të lumit kuotat ulen dukshëm në dhjetëra metra më poshtë, ndërsa kodrat përreth ngrihen shpejt.

Struktura, në të cilën do të ndërhyet, gjendet në fshatin Brataj, Njësia Administrative Brataj, Bashkia Selenicë.



Lugina është e gjerë dhe aluvionale, me tarraca zhavorrore/ranore dhe shpate të pjerrëta kodrinore që kufizojnë fushën e lumit. Shushica qarkullon midis masiveve Kundesh–Kurvelesh në lindje dhe Cikë–Lungara në perëndim, çka krijon profil të theksuar V–U me dalje në fusha të vogla bujqësore. Fusha e luginës përdoret për bujqësi dhe kullota, me bërthama banimi në tarraca të ngritura mbi shtratin e lumit; përgjatë rrjedhës ka lidhje me fshatrat Lepenicë, Gjorm, Gumenicë, Kotë e Drashovicë

- **Të dhënat gjeoteknike**

Zona rreth fshatit Brataj është tepër e varur nga struktura karstike dhe formacione gjeomorfologjike, që ka rëndësi direkte për projektet inxhinierike, sidomos në zonat e përgjegjshme për ndërtime si ura. Kjo përfshin çështje si:

- Karakteristikat litologjike: bazamente gurorë, shpella, formacione karstike – mund të imponojnë kërkesa ekstra për studimet gjeoteknike.
- Erozioni i sipërfaqeve të terrenit më i predispozuar ndaj hapjes së çarjeve dhe deformimeve, veçanërisht pranë ujërave sipërfaqësore si Shushica.
- Thellësia e themelit: shpellave dhe formacioneve karstike mund të kërkojë sondazhe më të thella dhe zgjidhje të specifikuar.

- **Të dhënat sizmike**

Zona e jugut-perëndimit të Shqipërisë (përfshirë rrethinat e Vlorës/Bratajt) është zonë me aktivitete sizmike të larta. Për qëllime projektimi (Eurokod 8 / EN1998) duhet përdorur një hartë probabilistike të rrezikut sizmik (PGA për 10% prob. në 50 vjet, RP = 475 vjet) dhe të përcaktohen parametra specifike të vendit (p.sh. Vs30). Studimet kombëtare dhe hartat e rrezikshmerise sizmike


tregojnë vlera të PGA në shkallën ~0.24–0.30 g në bregdetin/jug perëndimor (Vlora dhe zonat rreth e saj). PGA (referencë për nxitimin bazë, kategoria e tokës (10% në 50 vjet). Përdorni i një vlerë orientuese PGA ≈ 0.24–0.30 g për fshatin Brataj (raportohet për zonën e Vlorës dhe jug-perëndim e Shqipërisë). Kjo vlerë duhet konfirmuar me hartat PSHA zyrtare (IGEO / GSHAP / GEM) dhe me indeksimin e pikës gjeografike të urës

III. Përshkrimi i skemës së zgjedhur

- **Tipi i urës**

Projekti i Urës prej beton armeje mbi shtratin e Lumit Shushicë duhet të ketë një gjatësi prej rreth 70 metra dhe të realizohet me 2 hapsira drite me Trarë të Parapërgatitur te parafabrikuar (Formë T) prej Beton Armeje C45/55, projektimi i saj do të bëhet sipas standarteve të projektimit shqiptare dhe Eurocode 8 . Ura do të ketë një gjerësi totale prej 6 metra, e cila do të përbëhet nga 1 korsi për kah levizjeje prej 2 metra, dhe me 2 bankina të asfaltuara prej 0.5 metra secila, dhe një trotuar në njerën anë të urës me gjerësi 1metër, ndërsa në anë tjetër do të realizohet një bordurë prej 0.5 metra mbi të cilën do të vendoset parapeti mbrojtës anësor, (Guardrail)

Nën struktura do të realizohet prej beton armeje, do të ketë një formë rrethore, ndërsa themelet do të jenë të tipit të thella me pilota me diametër rreth 1000 -1200 mm.



Konfigurimi Struktural dhe Zgjedhja e Trarëve


- **Trajtimi i trarëve:** Trarët janë me formë T të përmbysur, e cila ofron një raport të mirë mes rezistencës dhe materialit të përdorur.
- **Materiali:** Beton C45/55 i parapërgatitur, me armaturë të paranderur (pre-stressed reinforcement).
- **Dimensionet:** Për hapësira ~ 35 metrash, trarët do të kenë dimensione që sigurojnë kapacitetin e kërkuar (dimensionet e sakta llogariten më poshtë).
- **Numri:** 3 trarë për secilën hapësirë, të shpërndarë në mënyrë uniforme në gjerësi urë.
- **Ngarkesat që veprojnë mbi urë**
- **Ngarkesa vetë-pesha** (për betonin dhe armaturën)
- **Ngarkesa nga trafiku:** Ngarkesa për automjete sipas standardeve Eurocode 1 (EN 1991-2)
- **Ngarkesa për këmbësorët:** Për pjesën e këmbësorëve do përdoret ngarkesa uniforme e përshtatshme sipas Eurocode 1
- **Ngarkesat dinamike dhe sizmike** sipas Eurocode 8 (EN 1998) për zonën e Vlorës

• Gjeometria

Ura projektohet për të shërbyer si një kalim automobilistik dhe këmbësorësh mbi një pengesë natyrore ose artificiale që në rastin në fjalë është Lumi Shushicë pranë fshatit Brataj.

Sistemi struktural përbëhet nga trarë të parapërgatitur prej beton armeje në formë T, me klasën C45/55 të betonit..

Skema e përafërt



Ngarkesat termike

- **Temperatura:** variacionet ditore dhe sezonale → zgjerim/kontraktim i soleta e ures.
- **Tkurja e betonit** në kohë → deformime afatgjata.
- **Efekte të kufizimit termik:** veçanërisht në nyjet e dilatimit dhe çernierat.

Ngarkesat sizmike dhe dinamike

- **Ngarkesa sizmike:** sipas EN 1998-2, duke marrë PGA për zonën e Bratajt (~0.24–0.30 g, klasa tokës përcaktohet me Vs30).
- **Faktorë shtesë:** goditje (pounding) midis segmenteve, ndërveprim tokë–strukturë, efektet dinamike të trafikut (impact factor ϕ).

Kombinimet e ngarkesave

Sipas EN 1990 – Basis of Design, përdoren dy grupe kryesore:

- **ULS (Ultimate Limit State – gjendja kufitare e fundit)**
 $\gamma_G \cdot G + \gamma_Q \cdot Q$
ku $\gamma_G \approx 1.35$, $\gamma_Q \approx 1.5$ (vlera tipike).
- **SLS (Serviceability Limit State – gjendja kufitare e shfrytëzimit)**
 $G + Q$ (kontroll deformimesh, çarjesh, gjendja kufitare e perdorimit)
- **Kombinime speciale:** ngarkesat sizmike, impakte të jashtëzakonshme (goditje automjetesh, shpërthime, etj.) kontrollohen veçmas.

V. Predimensionimi i strukture

Mbi struktura e ures do te realizohet me nje hapsire drite prej 35 m, momenti maksimal i perkuljes per nje tra te thjeshte, te mbeshtetur ne dy skaje, me ngarkese uniforme q (kN/m), eshte:

$$M_{\max} = qL^2 \cdot \frac{1}{8} \quad M_{\max} = 8qL^2$$

Ku:

- $L = 35 \text{ m}$, $mL = 35 \text{ m}$
- q = ngarkesa totale e llogaritur (vetë-pesha + ngarkesa e trafikut + ngarkesa këmbësorë)

(Këtu duhet të llogaritet q sipas ngarkesave konkrete.

Dimensionimi i Piles Qendrore

Pilë me diametër 2.7 m qëndron në mes të urës dhe përçon ngarkesat e dy trarëve në themel.

Dimensionimi bazik përfshin:

- Kontrollin e kapacitetit mbajtës dhe qëndrueshmërisë së piles.
- Dimensionimin sipas Eurocode 8 për rezistencën ndaj tërmetit (ngarkesat sizmike).
- Thellësia e piles nëntokësore do të përcaktohet në varësi të terrenit

Elemente Shtesë

- **Pllaka bashkevepruese (Soleta)** e betonit mbi trarë për shpërndarjen uniforme të ngarkesave.
- **Trotuaret** anësore për këmbësorët, të mbrojtura me bordura dhe parapet.
- **Drenazhimi** për largimin e ujit mbi sipërfaqe.
- **Sigurimet e sigurisë** parapet sigurie rrugore (H2) në anën pa trotuar; **parapet pedonal** + mbrojtës anësor në anën tjetër

Tabela e Materialeve

Materiali	Sasia
Beton C45/55	Vëllim i llogaritur sipas dimensioneve të trarëve, pllakës dhe pilës
Armaturë e paranderur	Llogaritur në bazë të ngarkesave dhe dimensioneve të trarëve
Çeliku	B500C

Përfundime dhe Rekomandime

- Ura e projektuar është e përshtatshme për përdorim automobilistik dhe këmbësorë.
- Përdorimi i betonit C45/55 dhe armaturës të paranderur garanton qëndrueshmëri dhe siguri.
- Projektimi sipas Eurocode 8 siguron rezistencë ndaj ngarkesave sizmike.
- Rekomandohet kontroll më i detajuar i terrenit për përcaktimin e thellësisë së pilës.
- Sugjerohet monitorim i rregullt i urës pas ndërtimit për sigurinë afatgjatë.

VI. PËRSHKRIMI I SHKURTËR I GJENDJES AKTUALE

Ura objekt detyre projektimi shtrihet mbi **Lumin Shushicë**, i cili ka një gjatësi rreth 80 km, është një prej degëve kryesore të Vjosës.

Ky lumë kalon përmes një peizazhi të qetë dhe bujar në jug të Shqipërisë, përfshirë fshatin Brataj, ku bujqësia dominon luginën. Ura historike e Bratajt — e shekullit XVI me dy harqe — është një monument i gjallë i trashëgimisë dhe lidh urën me dy bregje lumit.

Shushica është tani pjesë e **Parkut Kombëtar Vjosë** (që nga marsi 2023), dhe mbrohet nga komuniteti dhe organizata mjedisore dhe rekomandime ndërkombëtare për mbrojtje të plotë.

Sic përmendet me lart fshati Brataj lidhet historikisht me urën e vjetër historike me harqe e cila është një vepër arti historike e cila nuk shërben për ndërlidhjen ekonomiko shoqërore të fshatit, kjo sjell nevojën urgjente të një lidhje, pra një ure të re automobilistike me kalim edhe pedonal e cila do ti shërbej fshatit Brataj dhe jo vetëm.

Ura mbi Lumin e Shushicës do të jetë një urë në të cilën kalojnë banorët dhe mjetet e transportit rrugor, e gjatë ~ 70 metra ka një hapësirë drite ~35 m dhe gjerësi 6 m duke garantuar edhe një kalim këmbësor në njërin anë. Ura do të jetë prej betonarmeje me themele të thella në shtratin e lumit, kollona qëndrore rrethore me diameter ~2.7metra e plotë, mbistruktura prej trarësh beton armeje me armaturë të paranderur.

Si rezultat i mos ekzistencës së një lidhjeje të qëndrueshme, kjo situatë sjell rrezik të menjëhershëm dhe nevojitet një ndërhyrje urgjente.

VII. Kërkesat teknike planimetrike – kompozicionale dhe infrastrukturore

Projektuesi duhet të kryejë të gjithë punën në përputhje me standardet e projektimit dhe ndërtimit që janë në fuqi në Shqipëri.

Gjatë hartimit të merren parasysh kondicionet e PPV Bashkisë Selenicë. Projektuesi duhet të marrë në konsideratë legjislacionin në fuqi për ndërtimet, kryesisht: Ligji 107/2014 Për planifikimin e zhvillimit të territorit, i ndryshuar, Ligji nr 8402 date 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar.

Hartimi i projekteve specifike, të shtjelluar në vijim, duhet të mbështetet në studimet e thelluara të gjendjes faktike. Çdo dokument teknik që disponohet nga institucioni në shërbim të procesit të projektimit do t’i vendoset në dispozicion grupit të projektimit.

Gjithashtu grupi i projektimit do të duhet të bëjë një rievitim faktik arkitektoniko-konstruktiv të strukturës .

Grupi i projektimit do të duhet të bëjë percaktimin e sakte të nderhyrjes në ndërtimin e ures dhe sistemit të skarpave të lumit Shushica.

Për objektet e përfshira në këtë shërbim konsulenti duhet të hartojë:

1 Raport Studimor Paraprak

Në këtë raport studimor Konsulenti duhet të studiojë ndërhyrjen duke konsideruar të gjithë gjatësinë e lidhjes nga rruga kryesore përfshirë edhe urën. Ky raport duhet të përmbajë:

1.1 Inspektim vizual dhe përshkrim i gjendjes aktuale të zonës ku do të ndërtohet ura dhe zona përreth lumit.

Përshkrimi duhet të përmbajë relacion shpjegues mbi mënyrën e realizimit të veprës nga pikëpamja tekniko-inxhinierike.

1.2 Metodologjia e ndërtimit

Konsulenti duhet të përshkruajë mënyrën se si do të kryhet projektimi dhe ndërtimi i veprës nga pikëpamja teknike, llogjistike dhe programore, përgatitjet e materialeve dhe transportin gjatë zbatimit.

1.3 Horografi

Konsulenti duhet të hartojë një horografi në shkallën 1:10,000 ku të tregohet i gjithë ura me reperat referues në kuota absolute (në hartë dhe në formë tabele).

1.4 Planimetri

Konsulenti duhet të hartojë një planimetri në harta të shkallës Sh:1: 25000 , 1:10000, si dhe në shkallën 1:100; 1:200 dhe 1:500 që tregojnë:

- i) Emërtimin e skemës dhe Bashkinë përkatëse.
- ii) Zonën ku bëhet ndërtimi i veprës, rrugët, fshatrat, etj
- iii) Sipërfaqen që mbulon
- iv) Veprat e artit ekzistuese apo të reja që rehabilitohen (Shk 1:10,000).
- v) Zonat e veprave që do trajtohen (Sh. 1:10,000)
- vi) Legjendën.
- vii) Planimetria do të përpunohet edhe në versionin AUTOCAD

Relacion teknik

Ky relacion do të trajtojë çështjet teknike që lidhen me urën dhe skarpatet dhe masa e zgjidhje teknike për përmirësim apo modernizim të tyre. Relacioni do të përmbajë:

- i) Gjendjen ekzistuese të skarpateve
- ii) Gjatësinë e gjerësinë e urës dhe gjatësinë e lartësinë e skarpateve .
- iii) Punimet në këto vepra .

Për hartimin e Raportit Paraprak, Konsulenti duhet të studiojë dhe të marrë në konsideratë çdo projekt apo studim të mëparshëm që ndodhet në Drejtorinë e Ujitjes dhe Kullimit, Bashkinë Selenicë apo burim zyrtar tjetër.

Kërkesat teknike kundrejt shërbimeve që i takojnë nëntokës.

Shërbimet që i takojnë nëntokës duhet të paraprijnë procesin e projektimit. Hartimi i tyre duhet të respektojë kuadrin ligjor në fuqi dhe eurokodet aktuale.

Kërkesa të përgjithshme.

Gjatë hartimit të projektit do të mbahet kontakt i vazhdueshëm me autoritetet e Institucionit dhe grupin e punës së përpilimit të detyrës së projektimit, i cili do të vendosë në dispozicion të grupit të punës për hartimin e projektit një fotokopje të dokumenatcionit tekniko – juridik që disponon, në shërbim të procesit të projektimit;

Autorët e projekteve duhet të marrin përsipër përveç realizimit të planeve dhe skicave (vizatimet teknike) të përshkruajnë në mënyrë të detajuar të gjitha zërat e punimeve që do të përmbajë preventivi;

Projekti të shoqërohet me një relacion teknik ku të përshkruhen saktë zgjidhjet e ofruara teknike, avantazhet dhe prioritetet e tyre, materialet dhe paisjet e përdorura, vetitë dhe karakteristikat e tyre; Gjithashtu, grupi i projektimit duhet të marrë përsipër konsultat me zbatuesin si dhe predispozicionin për tu angazhuar në ndryshimet e mundëshme që mund të lindin, si pasojë e situatave të paparashikuara apo shmangieve si evoluim i kërkesave të investitorit në procesin e realizimit;

Projekti duhet të përfshijë dhe specifikimet teknike për materialet që do përdoren, por projektuesi duhet të ketë kujdes të mos përcaktojë markën apo çdo detaj tjetër që identifikon prodhuesin.

Kërkesa të veçanta.

Zgjidhjet dhe ndërhyrjet e propozuara duhet të bazohen në kritere të tilla:

- Të kenë ndikim minimal në mjedis.
- Të jenë propozuar në përputhje me funksionin e strukturës.
- Çdo ndërhyrje të jetë e mirëjustifikuar nga pikëpamja teknike dhe funksionale.

Ky raport do të dorëzohet 15 ditë pas datës së fillimit të kryerjes së shërbimit.

VIII. Shërbimet e kërkuara sipas fazave.

Grupi i projektimit duhet të kryejë shërbimet e mëposhtme:

Hartimin i projekt preventivit duhet të përfshijë fazat si vijon:

Kosto totale do të përcaktohet nga preventivi përfundimtar i objektit, që do të përgatitet bazuar në projektin e zbatimit, specifikimeve teknike, relacionin, si dhe duke marrë parasysh dhe kërkesat e veçanta të Bashkisë në lidhje me standardet e pranuar.

Në hartimin e preventivit çmimet e referencës do të jenë sipas legjislacionit, mbështetur në Manualin Teknik të Çmimeve në fuqi, në sistemin e integruar në 'e -albania'. Për zërat e punimeve që nuk gjenden në manual, projektuesi duhet të hartojë analiza përkatëse, të cilat do të bashkëlidhen të detajuara projekt zbatimit, kjo për të siguruar kursimin dhe efikasitetin e përdorimit të fondeve.

Faza I - Analiza e detyrës së projektimit / përcaktimi i bazës së projektit.

Faza III - Projektideja përfundimtare.

Faza IV - Projekti për miratimin e lejes së ndërtimit.

Faza V - Projekti i zbatimit.

Faza VI - Preventivi përfundimtar bazuar në Manualin Teknik të Çmimeve në fuqi, në sistemin e integruar në 'e -albania'.

IX. Standarde në Projektim

Projekti do të hartohet në përputhje me të gjitha normat dhe standardet për projektim që parashikon legjislacioni në fuqi. Projektimi duhet të sigurojë respektimin e standardeve, madje edhe atyre gjatë zbatimit. Është përgjegjësi e projektuesit saktësia dhe respektimi i të gjitha standardeve dhe normave përkatëse.

Projektuesi mund të rekomandojë edhe prezantimin e standardeve të reja, për përafrimin me normat e BE-se, si dhe të praktikave më të mira ndërkombëtare në projektim dhe zbatim. Rekomandimet duhet të përmbajnë elemente të fizibilitetit dhe realizueshmërisë me praktikën shqiptare dhe limitimet për financimin e veprës.

Në projekt të parashikohet infrastruktura e nevojshme për këtë kategori, e cila hyn në kategorinë F.

Detajet teknike të infrastrukturës për këtë kategori, të jepen nga Projektuesi në Fletë të veçanta të Projektit.

Standarde në paraqitjen e dokumentacionit teknik

Në hartimin dhe paraqitjen e dokumentacionit të projektit, projektuesi të përdorë programet e kërkua kompjuterike, si dhe të nxitet përdorimi i programeve të reja, me të avancuara të fushës.

Në hartimin, paraqitjen dhe miratimin e dokumentacionit teknik të projektit të kihen parasysh dhe të respektohen të gjitha kërkesat dokumentare dhe të paraqitjes që parashikon Ligji "Për planifikimin e territorit" i ndryshuar.

X. Metodologjia e punimeve për L~70 metra mbi lumin Shushicë në Fshatin Brataj

• Përgatitja e kantierit

Pastrimi i terrenit dhe sistemimi i aksesit nga rruga ekzistuese lokale.

Vendosja e piketave gjeodezike për aksin e urës.

Ndërtimi i rrugëve provizore për futjen e mjeteve të rënda (vinça, betoniere, kamionë).

Vendosja e impiantit të përkohshëm për prodhimin e betonit (ose sigurimi nga impiant pranë qytetit të Vlorës).

Organizimi i zonës së magazinimit për trarët e parafabrikuar dhe elementet metalike.

• Ndërtimi i themeleve dhe nën strukturës

Kryerja e gërmimeve për themelet dhe pilotat sipas projektit gjeoteknik.

Nëse shfaqet ujë në shtrat → përdorim diga provizore prej panele çeliku ose thasë me zhavorr) për tharjen lokale të zonës së punës.

Vendosja e sondes së shpimit.

Armimi dhe betonimi i themeleve dhe ngritja e kolonave (pila).

Hidroizolim dhe mbrojtje anësore me shiresa gabione.

- **Ngritja e trarëve të parafabrikuar**

Transporti i trarëve prej impiantit të prefabrikimit deri në kantier me trailerë specialë.

Përdorimi i vinçave me kapacitet ≥ 300 ton për ngritjen e çdo trari 35 m.

Vendosja e trarëve mbi mbeshtetje elastomerike në kubat e piles.

Kontrolli i nivelit dhe drejtimit pas vendosjes së çdo elementi.

- **Betonimi i pllakës bashkëvepruese (Soleta e ures)**

Vendosja e kallëpeve anësore dhe skelave provizore mbi trarë.

Montimi i armaturës së pllakës bashkëvepruese dhe lidhja me trarët.

Betonimi i pllakës në faza të kontrolluara për të shmangur mbingarkesa lokale.

Kujdes i veçantë për lidhjen me trotuarin e këmbësorëve dhe parapetet anësore.

- **Punimet përfundimtare**

Hidroizolimi i soletes dhe vendosja e shtresës asfaltike (4–6 cm).

Montimi i parapeteve metalike dhe mbrojtëseve anësore.

Ndërtimi i trotuarit pedonal me bordura dhe shtresë betoni/asfalti.

Sistemimi i hyrjeve në urë me mbushje dhe skarpatim.

Vendosja e masave mbrojtëse të brigjeve (rip-rap, gabione).

- **Organizimi i kantierit dhe akseset**

Vendndodhja e kantierit kryesor: në një nga brigjet e lumit me sipërfaqe të mjaftueshme për depozitimin e elementeve dhe pajisjeve.

Rrugë aksesore: krijohen rrugë provizore për lidhjen me rrugën ekzistuese lokale të kategorisë F.

Zona për parafabrikim: nëse trarët prodhohen në vend, parashikohet një hapësirë e sheshtë afër kantierit me kallëpe metalike dhe vinç portativ.

Zona e sigurisë: përreth brigjeve dhe ujit, me sinjalistikë dhe barriera provizore.

Kujdes për mjedisin: depozitimi i inerteve dhe ujërave të ndotura bëhet në zona të përcaktuara për të shmangur ndotjen e lumit.

- **Pajisjet e nevojshme**

Vinça të rëndë (150–300 ton) për ngritjen e trarëve 35 m.

Kamionë-trailer për transportin e elementeve të mëdhenj jashte norme.

Betoniera / impiant betoni mobil për betonimin në vend.

Pompa betoni për vendosjen e betonit në pllakë.

Kallëpe metalike dhe skela tubolare për soleten e ures dhe parapetet.

Ekskavatorë dhe buldozerë për gjermim dhe sistemim.

Kompaktorë për mbushjet.

Pajisje matëse: nivelatorë optikë, stacion total për kontrollin e aksit dhe kuotave.

Pajisje sigurie: rripa sigurie, helmetat, sinjalistika, barriera të përkohshme.

XI. Realizimi i Projektit

Projekti i paraqitur për struktura

“NDËRTIM URE ME HD = 2x35 m MBI LUMIN SHUSHICË” .

URË QË BASHKON RRUGËN E LUMIT TË VLORËS SH76 DHE ANËN TJETËR TË FSHATIT BRATAJ, NJËSIA ADMINISTRATIVE BRATAJ .

BASHKIA SELENICË

, duke iu referuar VKM Nr. 354, datë 11.5.2016 “Për Miratimin e manualit të tarifave për shërbime në Planifikim Territori, Projektim, Mbikëqyrje Dhe Kolaudim” duhet të kalojë në këto faza:

Faza e I: Analiza e detyrës së projektimit e cila përfshin:

Shërbimet bazë:

- Qartësimi i kërkesave të detyrës së projektimit.
- Dhënia e konsultave mbi nevojën edhe shkallët e shërbimit.
- Përmbledhja e rezultateve
- Studimi i gjendjes
- Analiza e vendodhjes
- Planifikimi i punës
- Verifikimi i rëndësisë së mjedisit
- Verifikimi i pajtueshmërisë me mjedisin

Faza e II : Projekt-ideja përfundimtare (sistemet dhe planifikimi i integruar)

Projekt Idea duhet të realizohet në jo më pak se një variant, ku për secilin variant duhet të paraqitet relacioni teknik mbi ndërhyrjet, projekti i ndërhyrjeve, kostoja e ndërtimit për secilin variant dhe specifikimet teknike. Paraqitja e varianteve duhet të bëhet në bazë të ndërhyrjes, të rezultateve të vlerësimit të kostos së ndërtimit dhe asaj të shfrytëzimit.

Varianti me treguesit më social - ekonomik dhe teknik që do përzgjidhet , do vazhdoj procedurën e hartimit të projekt zbatimi.

Faza e III : Projekti për miratimin e lejës së infrastruktures.

Projektuesi gjithashtu duhet të parashikojë dhe projektin për miratimin e lejes së infrastruktures, i cili duhet të mbështetet në ligjin nr. 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit” i ndryshuar

Faza e IV: Projekti i Zbatimit

Të kryhet hartimi i Projekt - Zbatimit të objektit ‘me përmbajtjen si më poshtë :

- Raporti Teknik
- Rilevimi
- Raporti i Vlerësimit të Ndikimit në mjedis (VNM)
- Studimin hidro-gjeologjik

Konsulentit duhet të hartojë rilevimin e zonës ku është vendosur struktura në pikat nevralgjike të saj .

2.2 Projekt Zbatimi

Konsulenti do të hartojë projektin e zbatimit për uren

2.3 Volumet dhe Preventivi

Konsulenti do të hartojë volumet paraprake për të gjitha kategoritë e punimeve të projektit. Volumet do të llogariten mbi bazë të vizatimeve të projektit. Çmimet njësi për të gjitha punimet do të llogariten duke patur si referencë çmimet e miratuara me manualet në fuqi (*Preventivi me cmimet e sistemit te integruar te cmimeve VKM nr.216, Dt. 13.04.2023*).

Rekomandime për projektuesin

- Projektuesi duhet të përdorë dhe të rishikojë të gjithë informacionin ekzistues lidhur me zonën ku ndodhet ura.
- Projektuesi duhet të përdorë studimet dhe të dhënat paraprake që disponohen nga Bashkia e Selenicës, seksioni i Urbanistikës dhe nga kadastra.
- Cilësia e studimit duhet të jetë e tillë që të arrihet në standardin e kërkuar.

Gjithashtu projektuesi duhet të paraqesë

- Plani i vendosjes së strukturës në shkallën 1 : 1000 format A3, i cili do të hartohet në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit pranë Bashkisë së Selenicës.
- Rilevim topografik .
- Licencë të shoqërisë projektuese + ekstrakt të Regjistrisë Tregtare
- Licenca të inxhinierëve projektues, licenca të ekspertit mjedisor + deklarata noteriale të inxhinierëve projektues.
- Projekti i sinjalistikës .

XII. Përfundime

Raportet dhe dokumentat duhet të jenë në 5 (pesë) kopje, në gjuhën shqipe ku njëra nga kopjet të jetë e printuar me ngjyra. Vizatimet duhet të jenë të lexueshme në formatin “dwg” (AutoCad 2007-2012). Të gjitha materialet do të dorëzohen edhe në soft-copy (në 5 CD).

Relacioni teknik që shoqëron projektin duhet të përmbajë:

- Raportin teknik të projektimit konstruktiv ku duhet të përfshihet edhe raporti mbi llogaritjet për strukturat
- Specifikimet Teknike të cilat duhet të jepen për çdo zë pune.
- Rekomandime dhe propozime për raste të veçanta.
- Raporti i Vleresimit të Ndikimit në Mjedis
- Raport teknik; Preventiv; Rilevimi.
- Studimin hidro-geologjik
- Grafiku i punimeve.
- Projektin konstruktiv
- Licensat e stafit projektues.
- Deklaratat e përgjegjësive profesionale të stafit pjesëmarrës në hartimin e projektit. Dorëzimi final, fizik, i projektit të zbatimit,

Investimi Themelor

Investimi themelor do të dal nga varianti më i mirë tekniko-ekonomik i aprovuar nga Bashkia Selenice.

Sqarime të fundit

Në hartimin e Raportit Studimor Paraprak dhe projektit të zbatimit do të shfrytëzohet edhe arkiva e teknike e Drejtorise se Ujitjes dhe Kullimit dhe e Bashkise Selenice . Për këtë qëllim, firma konsulente e interesuar, përpara se të dorëzojë ofertën e saj, duhet të marrë kontakte me Drejtorine e Ujitjes dhe Kullimit dhe e Bashkise Selenice dhe institucionet e tjera në lidhje me disponibilitetin e materialeve që do ti nevojiten.

Afatet për realizimin e projektit

Afati për hartimin e Projekt zbatimit dhe të preventivit përfundimtar do të jetë jo më vonë se **2(Dy)** muaj nga data e lidhjes së kontratës.

Marrja në dorëzim

Marrja në dorëzim e dokumentacionit të shërbimit (raporte, projekte etj.) do të bëhet nga grup me specialistë të Bashkise Selenicë .

Punoi : Ing. Deana Çeçi



Ark. Fatjon Devollaj

Ark. Sara Bregu



Ark. Katerina Tralo



